



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 24.
Prishtinë, më 15.12.2011 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Elmi Reçica

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues EUSR Visar Bivolaku, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr 04/ L-46, për Transmetimin Publik të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbrojtjen e Kufirit Shtetëror, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore nr. 04/L-67, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi- konstatoi se rendi i ditës u miratua me agjendën e caktuar të datës 14.12.2011 me shumicë të votave dhe me dy kundër.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 2.12.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr 04/ L-46, për Transmetimin Publik të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim Projektligjin nr 04/ L-46, për Transmetimin Publik të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje lidhur me Raport amendamentet e paraqitura nga Komisionit Funksional.

Petar Miletic – në fjalën e tij theksoi se ka informatë nga kryetari i komisionit funksional se raporti me amendamente nuk është në formën përfundimtare.

Njëherit ka pas kontakt edhe me Zyrën e ICO –së, Piter Feir dhe se lidhur me projektligj është diskutuar se ka një rendësi të veçantë për komunitetet e veçanërisht për komunitetin serb.

Dhe si çështje me rëndësi është hapja e kanaleve televizive për komunitetet jo shumicë ku parashihet edhe me pakon e Ahtisarit.

Bazuar në këto të dhëna, ai propozoi se Projektligji duhet të shtyhet deri sa Komisioni ti ketë të gjitha faktet e cekura më lartë, dhe më pas komisioni do të rishqyrtoj projektligjin.

Kryesuesi, pas shqyrtimit të propozim amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funksional, në Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave nr 04/ L-44 , dhe në bazë të propozimit të dhënë nga z. Petrovic, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni vendosi me shumicë të votave dhe tri kundër, që Projektligji nr 04/ L-46, për Transmetimin Publik të Kosovës të shtyhet për një periudhë të pacaktuar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbrojtjen e Kufirit Shtetëror, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbrojtjen e Kufirit Shtetëror, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbrojtjen e Kufirit Shtetëror dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore nr. 04/L-67, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore nr.04/L-67, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore nr.04/L-67 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi- tha se komisioni në bazë të Planit të Veprimit është në procedim të monitorimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Komisioni ka vizituar Komunën e Graçanicës, Hani i Elezit, Mamushën dhe Prizrenin dhe në vazhdimësi të procesit të monitorimit të ligjit, Komisioni do të vizitoi Kuvendin Komunal të Shterpës.

Për informata të sakta lidhur me këtë vizitë do të njoftoheni me kohë nga administrata për mbështetje të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic